



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:211050

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05484029

Ac.nr.88/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci, kryetari i kolegjit, Halide Reka dhe Naime Ahmeti - anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B nga Komuna e F..., Rruga "N.A", të cilin e përfaqëson me autorizim Korab Buçinca nga Ferizaj Rruga "N.A", kundër të paditurit B.A nga fshati G.P, Komuna Sh., të cilin e përfaqëson me autorizim Valdet Zeqiri, avokat nga Komuna e Lipjanit, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.107/19, të datës 02.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 08.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurit B.A nga fshati G.P, Komuna Shtime ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.107/19, të datës 02.10.2020 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.107/19, të datës 02.10.2020, ka vendosur në vijimë: *"I.APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit A.B nga F... Rr. "N.A", si e bazuar. II.VËRTETOHET se paditësi është pronar i përbashkët sipas të drejtës së trashëgimisë me 3/10 e pjesës ideale në NK.nr.401-0, në sipërfaqe prej 5.388m², e cila paluajtshmëri ka sipër të përgjithshme prej 17.941m² e cila ngastër gjendet në vendin e quajtur "Pojata" ZK G.P. III. DETYROHET i padituri B.A nga fshati G.. K.. Sh.. që t'ia liroj paditësit pjesën e paluajtshmërisë NK.nr.401-0, pjesën ideale prej 3/10 dhe atë në sipërfaqe prej 5.388m², me kufijtë dhe përmasa si në vijim nga ana veriore që kufizohet me NK.nr.400-0, në gjatësi prej 201.44m, nga ana perëndimore me pjesën e NK.nr.395-0, në gjerësi prej 6.15m, nga ana jugore me pjesën e NK.nr.401-0, në gjatësi prej 184.15m, kurse nga ana lindore me pjesën e NK.nr.849-0, në gjatësi prej 51.53m, e cila ngastër gjendet në vendin e quajtur "P.." ZK G.P, nga sendet dhe njerëzit dhe t'ia dorëzoj në posedim të qet dhe të pa penguar nga askush brenda afatit prej*

15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. IV. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit përmes të cilës ka kërkuar që të DETYROHET i padituri që t'ia liroj pjesën e paluajtshmërisë NK.nr.401-0, pjesën ideale prej 3/10 dhe atë në sipërfaqe prej 5.388m², me kufijtë dhe përmasa si në vijim nga ana veriore që kufizohet me pjesën e NK.nr.401-0, në gjatësi prej 170.66m, nga ana perëndimore me pjesën e NK.nr.395-0, në gjerësi prej 4.49m, nga ana jugore me NK.nr.855-1, në gjatësi prej 173.70m, kurse nga ana lindore me NK.nr.849-0, në gjatësi prej 51.53m, e cila ngastër gjendet në vendin e quajtur "P..." ZK G.P. V. DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 175€, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit".

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, i padituri përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datën 06.03.2013, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurit, për lirim paluajtshmërie, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, pasi që ka mbajtur seancën kryesore dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.107/19 të datës 02.10.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se përmes nxjerrjes së provës përmes dëgjimit të dëshmitarëve dhe me rastin e nxjerrjes së provë përmes daljes në vendin kontestues së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka vërtetuar faktin se pronën kontestuese e shfrytëzon i padituri të cilën e ka mbjellë me kulturë misër dhe sipas gjendjes faktike është një pronë e vetme e cila nuk ka ndarje fizike në teren, por me propozimin e paditësit është bërë matja sipas gjendjes faktike në dy versione, kur versioni i parë

të cilin e ka kërkuar paditësi që t'ia liron i padituri referohet pjesës së pronës që kufizohet me lumin ashtu siç është në pikën III të dispozitivit të cilin gjykata e ka refuzuar, kurse verizionin të dytë që e ka kërkuar paditësi është ai i përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të cilin gjykata e ka aprovuar, sa i përket pjesë së pronës të cilën e ka aprovuar gjykata e shkallës së parë ka marr parasysh gjendjes faktike se i padituri e ka në shfrytëzim, është e mbjellë me kulturë bujqësore, dhe pjesa që kufizohet me lumin gjykata ka konsideruar se duhet ti takoj të paditurit, për faktin se i njëjti dhe e punon pronën si tërësi dhe kjo pjesë është më e përshtatshme për mbjellje kurse me qenëse paditësi nuk e ka punuar asnjëherë këtë pronë dhe as pronat tjera si dhe bashkëpronarja tjetër Hatixhe Islami, nuk ka ndonjë interes për pjesën e saj gjykata ka konsideruar se duhet ti takoj pjesa e përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit, të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, pasi e ka konfirmuar se paditësi është pronar i përbashkët me pjesë ideale prej 3/10 të NK.nr.401-0, e duke u bazuar në nenin 18 të Ligjit për Pronën dhe Drejtave tjera Sendore thuhet *“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti”*, kurse në nenin 93 të këtij ligji thuhet *“Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi”*, andaj gjykata konsideron se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pasi që i njëjti ka të drejtë që sendin e caktuar, pronën ta kërkojë nga poseduesi i cili nuk ka të drejtë posedimi, në rastin konkretë edhe pse i padituri e ka në posedim me mirëbesim për shkak se paditësi e ka lejuar paraardhësin e të paditurit ta punoj, mbjell edhe pjesën e pronës së tij në rastin konkretë bazuar në nenin 97 të LPDTS-së konsiderohet se i padituri është posedues me keqbesim ku thuhet në par.1 *“Poseduesi është me keqbesim nëse ai ose detentori (mbajtësi) i tij ishte në dijeni ose ka mund të dijë, se nuk kanë pasur të drejtë posedimi”* kurse par.2. i këtij neni thuhet *“Si posedues me keqbesim konsiderohet edhe poseduesi nga çasti kur pronari kërkon kthimin e sendit ose kur paraqitet kërkesa sipas nenit 95 të këtij ligji”*

Andaj meqenëse është vërtetuar se paditësi është pronar i pjesë së pronës kontestuese të përshkruar sikurse në pikën -II- të dispozitivit, kurse posedues i saj është i padituri gjykata bazuar në arsyet e lart cekura ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka detyruar të paditurin që pjesën e paluajtshmërisë të përshkruar sikurse në pikën III të dispozitivit t'ia liron paditësit dhe t'ia dorëzojë në posedim të qet. Në raport me shpenzimet procedurale, gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke marrë për bazë nenin 452 të LPK.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e atakuar dhe duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, e për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri tek përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Po ashtu dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktgjykimit, kjo për faktin se në pikën -II- dispozitivit është vërtetuar pronësia e paditësit i cili në fakt nga shkresat e lëndës veç bashkëpronar sipas certifikatës së pronës të datës 04.07.2019, i pjesës së ngastrës kadastrale NK.nr.401-0, në pjesën ideale prej 3/10 dhe atë në sipërfaqe prej 5.388 m², e cila pjesë ideale është në emrin e paditësit si bashkëposedues, mirëpo faktikisht nuk dihet se cila pjesë fizikisht i takon paditësit, Në këtë rast paditësi është në bashkë posedim sipas certifikatës së lartcekur të pronësisë me Hatixhe Hajdini 2/10, e cila sipas shkresave të lëndës nuk ka shfaq ndonjë interesim lidhur me këtë çështje, ndërsa i padituri është në bashkë posedim me paditësin për 5/10, ngase e tërë ngastra lëndore si tërësi është në sipërfaqe prej 17941 m², prandaj nga kjo gjendje faktike nuk mund të konstatohet se a kemi të bëjmë në këtë rast me lirimi palujtshmërie apo me ndarje fizike, pasi që ndërgjyqësit janë bashkëpronarë/bashkëposedues. Përveç tjerash aktgjykimi i atakuar është marr edhe me shkelje

thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: me padinë e ushtruar me datë 06.03.2015, është kërkuar që të lirohet ngastra kadastrale NK.nr.401-0, në pjesën ideale prej 3/10, ndërsa përfaqësuesi i paditësit në fjalën përfundimtare të dhënë në seancën e datës 21.09.2020, ka kërkuar që paditësit ti njohët e drejta e pronësisë, të gjitha këto e bëjnë të paqartë kërkesën në padi është dhe se nuk është e specifikuar saktë kërkesa se çka kërkon paditësit në këtë rast, lirimi palujtshmërie, vërtetim pronësie apo ndarje fizike të sipërfaqes së përgjithshme të ngastrës lëndore. Në këtë rast gjykata para se të vendosë për kërkesëpadinë e paditësit, është dashur që padinë e paditësit ta kthejë në plotësim - korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së, duke i sugjeruar qartë korrigjimet të cilat duhet të bëhen me aktvendim të veçantë e nëse pala paditëse nuk vepron sipas këtyre sugjerimeve atëherë në këtë rast gjykata të vendos për padinë. Me nenin 102 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: *“Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do të thërras personin që e dërgon ta korrigjoj ose ta plotësoj parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”*, me paragrafin 2, të këtij neni, përcaktohet se: *“Në qoftë se parashtrësja e lidhur me afat korrigjohet, gjegjësisht plotësohet dhe i dorëzohet gjykatës brenda afatit të caktuar për një gjë të tillë, do të konsiderohet se i është parashtruar gjykatës në ditën kur është paraqitur për të parën herë”*, ndërsa me paragrafin 3, të po këtij neni, përcaktohet se: *“Do të konsiderohet e tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”*.

Gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejt dhe të plotë gjendjen faktike, rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, për arsye se: gjykata edhe pse ka dal në vend shikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës kadastrale - kontestuese, në të cilën paditësi ka pretenduar se ka të drejtën e pronësisë, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi, të identifikojë saktësisht se cila është pjesa ideale e paditësit që i takon në ngastër kadastrale, sepse ngastra kadastrale nr.401-0, në pjesën ideale prej 3/10 dhe atë në sipërfaqe prej 5.388 m², siç pretendon paditësi. Mirëpo nga shkresat e lëndës, nga dispozitivit i aktgjykimit të ankimuar e as nga arsyetimi i të njëjtit, gjykata e shkallës nuk e ka vërtetuar faktin se si ka ardhur në përfundim që cila pjesë e palujtshmërisë lëndore duhet ti dorëzohet paditësit në posedim dhe pse duhet ti dorëzohet e njëjta pasi që faktikisht nuk dihet se cila pjesë fizikisht i takon paditësit, pasi që në ngastrën e njëjtë është në bashkë posedim me Hatixhe Hajdini 2/10, dhe poashtu edhe me të paditurin për pjesën 5/10, ngase e tërë ngastra

lëndore si tërësi është në sipërfaqe prej 17941 m². Se cila nga pjesët ideale të sipërfaqes së përgjithshme të ngastrës lëndore i takon paditësit dhe pse i takon pikërisht ajo pjesë e ngastrës lëndore paditësit, duhet të sqarohet dhe vlerësohet nga gjykata e shkallës së parë çoftë në këtë procedurë apo të vlerësohet edhe mundësia që nëse kontesti ka bërë vetëm me ndarje fizike të zhvillohet paraprakisht ndonjë procedurë tjetër, para së të zhvillohet kjo procedurë. Pasi që duhet të përshkruhet saktësisht shtrirjen gjeografike të të pjesës së ngastrës që i takon paditësit, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë që i ndahet paditësit dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur me parcelën lëndore.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që t'i evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës (vlerësim i prezumimeve procedurale në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë dhe në seancën përgatitore). Ashtu që ta kthen padinë në plotësim, dhe të obligohet paditësi se çka kërkon nga gjykata, lirim paluajtshmërie, vërtetim pronësie apo ndarje fizike të ngastrës lëndore në pjesë ideale për secilin nga bashkë poseduesit-bashkëpronaret, ku njëri prej tyre është edhe i padituri. Pastaj varësisht prej rregullimit apo mos rregullimit-korrigjimit të padisë nga ana e paditësit, gjykata të ndërmer hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në mënyrë që të ketë mundësinë që të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore, siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.88/21 datë 08.03.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Adnan Konushevci